



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.102-4/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga anëtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin-kërkesën për rishikim të vendimit të subjektit politik Lëvizja për Bashkim, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-së me ZL.Anr.102/2017 të datës 03.10.2017, në Prishtinë, për shkak të paraqitjes së fakteve të reja, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 10.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar apeli-kërkesa për rishikim të vendimit nga ana e subjektit politik Lëvizja për Bashkim (LB), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të rishikohet vendimi ZL.Anr.102/2017 të datës 03.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP me vendimin ZL.Anr.102/2017 e datës 03.10.2017, ka vendosur lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), të bërë ndaj subjektit politik Lëvizja për Bashkim (LB) për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, ku për këtë rast PZAP ka pranuar ankesën e LVV-së si të bazuar dhe i ka shqiptuar subjektit politik LB dënim me gjobë në vlerë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

Subjekti politik Lëvizja për Bashkim (LB), më datë 04.10.2017, ka paraqitur në PZAP një apel-kërkesë nëpërmjet së cilës kërkon të rishikohet vendimi i PZAP-së ZL.Anr.102/2017 i datës 03.10.2017, për shkak të paraqitjes së fakteve të reja, me të cilën pretendon se lokacioni ku janë vendosur posterët e kandidatit për Kuvend Komunal të Prishtinës nga ky subjekt politik gjindet në lagje private gjegjësisht lagjja Qëndresa dhe lagjja Janina në Prishtinë dhe si e tillë kjo lagje në kadastrat komunal konsiderohet si hapësirë private e jo publike dhe me këtë rast rrugët e kësaj lagje janë rrugë Private, të caktuara edhe me shenja “rrugë private”. Gjithashtu, ka theksuar se në këtë lagje të gjitha investimet përfshirë edhe trafo stacionet janë investime të banorëve të lagjes dhe si të tilla nuk kanë pronësi publike por private dhe se trafo stacioni në fjalë nuk është në

funksion por është në ndërtim e sipër nga mirëmbajtësit e lagjes. I njëjti thekson se kërkesa për sanksionim ndaj subjektit politik LB nga ana e parashtruesit të ankesës LVV do duhej të konsiderohej e pa bazuar në aspektin ligjor sepse në atë ankesë kanë kërkuar që të ndërmerret masa e sanksionimit në përputhje me rregulloren e PZAP-së nr.01/2012 nenit 3.3.2.

Sipas dëshmive të kandidatit Kushtrim Sheremeti, të gjithë posteret në këtë lagje (10 copë) janë vendosur në hapsira private (dyqane të lagjes dhe shtëpi apo prona përcjellëse të banorëve privat pas konsultimit me ta) dhe asnjëherë kandidati apo mbështetësit e kandidatit nuk e kanë vendosur asnjë poster në vendin e pretenduar në ankesën e LVV-së.

Poster të vendosur në hapsira jo-publike në këto lagje janë dëmtuar nga dikush paraprakisht por edhe janë dislokuar. Një nga posterët e dislokuar ka qenë edhe posteri në fjalë i larguar nga prona private në rrugën “Dëshmorët e Loxhes” në të njëjtën lagje dhe e vendosur në trafo stacionin e pretenduar vetëm për qëllim ankimimi dhe dëmtimi të subjektit politik LB dhe kandidatit në fjalë. Në parashtrësën e datës 09.10.2017, subjekti politik LB ka deklaruar se në përgjigjen e LVV-së në asnjë moment nuk mohohen faktet dhe provat e prezantuara nga ana jonë.

Lëvizja për Bashkim ka kërkuar që të refuzohet si e papranueshme ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe të anulohet vendimi ZL.Anr.102/2017.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në përgjigje në apel, të datës 07.10.2017, thekson se pretendimet e subjektit politik LB, se posteret janë vendosur në rrugë private, të njëjtit theksojnë se ne si Lëvizje nuk mundemi të konstatojmë një gjë të tillë pasi aktivistët tanë në rastin e fotografimit të posterit nuk kanë hasur ndonjë rrugë që shkruan rrugë private. Përveç tjerash edhe nëse vendosja e posterit është në rrugë private duhet të merret leja e pronarit të asaj rruge sipas nenit 33 pika b) të LZP. Po ashtu çdo trafo stacion ka karakter publik dhe autorizime publike dhe në mbështetje të kësaj konsiderojmë se vendosja e posterave në çfarëdo trafo stacioni përbën shkelje të ligjit. Lidhur me masën e sanksionit të njëjtit theksojnë se është fakt se gabimisht dhe pa dashje kanë shkruar neni 3.3.2, mirëpo praktika e PZAP-së ka vërtetuar që kërkesa e bërë nga ndonjë subjekt politik nuk dmth të vendoset sipas kërkesës së subjektit politik dhe sanksioni vihet jo në bazë të kërkesës por sipas peshës së veprës/deliktit dhe rrethanave tjera të cilat gjinden në përmbajtjen e vendimeve të PZAP-së. I propozon PZAP-së që ta refuzoj kërkesën për rishikim të vendimit ZL.Anr.102/2017.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se apeli është i **pa bazuar**

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e subjektit politik LB, në apelin e datës 04.10.2017 dhe parashtrësën e dt.09.10.2017, pasi që i njëjti konstatoj se parashtruesi i apelit – kërkesës për rishikim të vendimit nuk e ka argumentuar me fakte të reja se rruga ku pretendohet se është bërë shkelja është hapsira jo-publike. PZAP-i në bazë të kompetencës që i është dhënë në bazë të nenit 118.4 të LPZ-së, mund të rishikoj cilindo nga vendimet e marra, pas prezentimit të fakteve të reja nga palët e interesuar apo për shkak të vullnetit të mirë të treguar. Në rastin konkret paneli vlerësoj se parashtruesi i kërkesës për

rishikim nuk ka parashtruar fakte që i përmbushi standardet ligjore në kuptim të dispozitës sipërcituar dhe për rrjedhojë kërkesa për rishikim u refuzuar si e pa bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke u bazuar nenin 117 par.2 dhe 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL.Anr.102-4/2017 më datën 10.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Zynder Haziri

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.